



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.148, datë 16.06.2023

PËR

“FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE  
FIGURËS PËR KANDIDATËT QË KANË KANDIDUAR PËR POZICION  
DREJTUESI, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.139, DATË 07.06.2023, TË  
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, nenet 159, pika 2 dhe 190, pika 2, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, pikat 2-7 të nenit 32, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, nenin 9, pika 4, të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të shpallur me Vendimin Nr.139, datë 07.06.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
  - a. Zoti Abaz Muça
  - b. Zoti Urim Buci
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 16.06.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Eloida Goxhi

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Zeqir Hoda



ANËTAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Arta Mandro

ANËTAR  
Ledina Riza

*[Faint, illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the page.]*

